



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit / Ministarstvo obrazovanja, nauke, tehnologije i inovacije / Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Kabineti i Ministres/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Ministrja e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr. 06 / L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare nr. 7/01 mars 2019), nënparagrafit 1.5 i paragrafit 1 të nenit 11 të Ligjit nr.08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (G.Z. e Republikës së Kosovës/nr. 34/18 nëntor 2022, Prishtinë), nenit 32 të Ligjit nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës,(G. z. e Republikës së Kosovës nr. 14/9 shtator 2011, Prishtinë), nënparagrafit 1.4, shtojcës 1 pikës 7 të Rregullores (QRK) nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe Vendimin e Ministres, nr. 01-148 dt. 23.09.2025, shpall:

KONKURS

Për mbështetje financiare për studentët e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, duke synuar mbështetjen e shkollimit të studentëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian që janë regjistruar për herë të parë në vitin e parë akademik 2025-2026 në nivelin bachelor në njërin nga Universitetet Publike në Republikën e Kosovës, shpall këtë thirrje.

Shuma e mbështetjes financiare është 1000.00 (euro) për studentë.

Kushtet për aplikim dhe përparësitë në konkurrim:

1. Aplikuesit duhet të jenë shtetas të Republikës së Kosovës;
2. Të jenë pjesëtarë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian;

3. Të jenë regjistruar për herë të parë (në vitin e parë) në studimet bachelor në njërën nga Universitetet Publike në Republikën e Kosovës;
4. Për të rritur përfaqësimin e grave në mesin e studiuesve, gratë do të zgjidhen me preferencë në rastet e kualifikimit të barabartë të kandidatëve gra dhe burra;
5. Përparësi kanë personat me aftësi të kufizuara;
6. Llogaria bankare aktive dhe personale në njërën nga Bankat në Republikën e Kosovës.

Dokumentet e kërkuara:

1. Dëshminë e regjistrimit në fakultet në njërën nga Universitetet Publike (Statusin e studentit/fletëregjistrimin);
2. Formularin e vetëdeklarimit mbi përkatësinë etnike;
3. Kopjen e letërnjoftimit;
4. Konfirmimin bankar për llogarinë personale aktive;
5. Nëse aplikohet, dëshmitë relevante të lëshuara nga organet kompetente për personat me aftësi të kufizuara sipas kushteve për aplikim dhe përparësive në konkurrim (pika 5).

Forma dhe procedurat e aplikimit :

1. Aplikimi bëhet përmes platformës e- Kosova
2. Dokumentet e pakompletuara nuk do të shqyrtohen nga komisioni
3. Lista e studentëve përfitues do të bëhet publike në uebfaqen e MASHTI-t.

- Konkursi do të jetë i hapur nga data 03.10.2025 deri më 18.10.2025, në ora 16:00.

E drejta e ankesës: Kandidatët që kanë aplikuar për përfitim të bursës, kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas shpalljes së rezultateve. Ankesat dorëzohen në arkivin e MASHTI-t, kati përdhese, zyra nr.4 dhe shqyrtohen nga komisioni për ankese dhe parashtrësia i MASHTI.